



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 37
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10
Prishtinë, më 27 shkurt 2019, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Drita Millaku, Time Kadrijaj, Fikrim Damka, Naser Rugova dhe Enver Hoti.

Munguan: Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli dhe Flora Brovina.

I ftuar: z. Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pjesëmarrës tjerë: Minire Balaj- MPMS, Mentor Tërshnjaku -MPMS, Bahri Xhaferi- MPMS.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me z. Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale**
-Reforma e sistemit pensional në Kosovë.
-Zbatimi i legjislacionit nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale.
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

- 2. Takim me z. Skender Reçica, Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.**
-Reforma e sistemit pensional në Kosovë.

Besa Baftiu, kryetare: Ministër, faleminderit që i jeni përgjigjur ftesës sonë që sot të jeni i pranishëm në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. E dimë që ju keni bërë një draft dokument sa i përket Reformës së sistemit pensional në Kosovë, por gjithashtu është formuar edhe një Komision parlamentar, i cili do të merret me këtë çështje.

Ne si antarë të Komisionit duam ta dimë arsyen përse Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti është parapa në strategjinë legjislative për plotësim dhe ndryshim. Ju e dini shumë mirë që në takimet që i kemi pasur si Komision, kemi kërkuar që ky Ligj të draftohet apo të amendamentohet në mënyrë urgjente. Keni thënë që jeni duke punuar në Reformën Pensionale. Ne jemi pajtuar dhe është e mirë që edhe pozita edhe opozita janë pajtuar që ka nevojë për një reformim të sistemit pensional, duke pasur parasysh që sistemi aktual ka qenë diskriminues ndaj shumicës, prandaj duam ta dimë çfarë ndryshimesh parashihihen të ndodhin në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti. A ka gjasë që Reforma Pensionale të vonohet shumë dhe a e keni parë si të arsyeshme që ky Ligj të draftohet dhe amendamentohet shpejt?

Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale: Tash e kemi vendimin e Parlamentit për krijimin e një Komisioni, që tash e tutje Reforma Pensionale do të drejtohet nga ai Komision. Unë mendoj që koncept dokumenti i reformës pensionale është një dokument i përgatitur dhe i studiuar shumë mirë, një dokument i cili ka dalë nga hulumtimet edhe në rajon edhe përtej rajonit. Koncept dokumenti i cili është tash në Qeveri, është një dokument i bazuar në fakte e që më së miri i përshtatet rrethanave socio-ekonomike të vendit tonë. Nuk duhet të harrojmë që i kemi mbi 20 skema pensionale, kemi 8 ligje që rregullojnë çështjen e skemave pensionale, kemi kohezion brenda ligjeve dhe të gjitha këto kanë hasur në vështirësi të ndryshme për zbatimin në praktikë të këtyre dispozitave ligjore. Bazuar në të gjitha këto, ne kemi pasur shumë kujdes gjatë hartimit të koncept dokumentit për të nxjerrë vijat se si do të hartohet ligji që do të rregullojë sistemin e pensioneve. Deri në vitin 2020, Kosova obligohet që të ketë Fondin e sistemit pensional. Ne kemi paraparë në këtë koncept dokumenti ti nxjerrin dy projektligje: projektligjin unik për sistemin pensionale në vend dhe projektligjin për Fondin e sigurimeve sociale. Sistemi pensional aktual është i përbërë nga Trusti Pensional i Kosovës dhe nga skemat e tjera të financuara nga shteti. Janë 23 skema pensionale të financuara nga Shteti, Fondi i kursimeve pensionale dhe shtylla e tretë janë pensionet vullnetare. Ne e kemi konceptuar sistemin pensional që të ndërtohet në bazë të katër shtyllave. Shtylla zero, e cila përfshin këto pensione: pensionin social të pleqërisë, pensionin kontributdhënës të viteve 99-të, pensionin invalidor para viteve 99-të, pensionet për aftësi të kufizuara, pensionet e kategorive të dala nga lufta dhe për kompensimin e lehonave të papuna. Shtylla një, do të krijohet nga pagesat për sigurime pensionale dhe invalidore dhe në këtë shtyllë do të financoheshin: pensioni i moshës, pensioni invalidor i punës, pensioni familjar, pensioni i parakohshëm. Shtylla dy, do të jetë Fondi i sigurimeve sociale dhe shtylla e tretë do të përfshijë përfitimet vullnetare.

Bekim Haxhiu: Duke e vlerësuar punën e juaj dhe koncept dokumentin për skemat pensionale dhe gatishmërinë e Parlamentit të Kosovës që ta ketë edhe një Komision, i cili do të punojë për atë që quhet Kodi pensional, kjo nuk do të thotë që duhet të ndalni punën të cilën e keni filluar, sepse besoj që është një punë bukur voluminoze, ku keni marrë në konsideratë të gjithë aktorët e interesit, dhe mund të vijmë në një fazë ku të dy komisionet dhe të dy dokumentet të harmonizohen në fazën finale dhe nuk do të thotë që ju të tërhiqeni nga ajo që keni punuar deri më tani.

Dua t'ju falënderoj edhe për nismën tuaj për rritjen e pensioneve për të gjitha kategoritë, por dua edhe një përgjigje nga ju se përse në rritjen e fundit nuk janë përfshi kategoritë e luftës, familjet e dëshmorëve, invalidët e UÇK-së, veteranët, viktimat e luftës etj. A ka pasur propozim prej anës

tuaj për rritje për kategoritë që i përmenda, nëse nuk ka pasur atëherë kërkoj që vërtetë të planifikoni që në rritje të përfshihen edhe këto kategori.

Ndryshimi i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti të mos tërhiqet nga strategjia, përkundrazi, të punohet në mënyrë intenzive dhe të mënjanohet ajo padrejtësi që i është bërë disa kategorive. Ne i kemi takuar edhe sindikatat e policisë edhe të tjera, të cilëve iu është mohuar kjo e drejtë, dikujt për dy tre muaj, që nuk ka arritur ta gëzojë pensionin kontributdhënës, që edhe atë padrejtësi ta eliminojmë.

Naser Rugova: Duhet të bëhemi real se Kosova është një vend në tranzicion edhe politikë edhe socio-ekonomik, por edhe legjislativ dhe është një konglomerat i ligjeve të trashëguara. Nganjëherë po nxitohemi në plotësimin dhe ndryshimin e një game të caktuar të ligjeve dhe pastaj korrespondon që ky ndryshim nuk është real me implementimin në terren. Ne po kemi problem me zbatim të ligjit sepse në Kosovë nuk ka mungesë të ligjeve.

Ministër, ka fokus grupe të njerëzve që kanë 14 vite e 350 ditë përvojë pune dhe ju mohohet e drejta e pensionit. Duhet ta bëjmë një zgjidhje ligjore, e cila tani duhet edhe me akte nënligjore të përcillet njëherë e përgjithmonë.

Është problem edhe me pensionistët kontributdhënës para vitit 99-të, është një fond pensional i grabitur nga Serbia dhe nuk e di shteti i Kosovës ku ka arritur në këtë drejtim, a ka marrë hapa të caktuar, a është formuar një komision të vlerësimit, a është planifikuar që kjo të hapet në çështjen e bisedave finale me Serbinë.

Kemi diskutuar edhe për pensionistët që janë jashtë vendit dhe që duhet të lajmërohen dy herë në vit në qendrat e pensioneve. Është mirë që të krijojmë një data bazë me një softuer të thjeshtë që ata njerëz të lajmërohen në ambasada dhe konsullata të Republikës së Kosovës, në mënyrë që t'ua lehtësojmë marrjen e pensionit të tyre meritator kontributdhënës.

Fatmire Kollçaku, pyeti ministrin se a është definuar mirë ndarja në mes pensionit dhe mbrojtjes sociale, kategoritë që duhen paguar nga Fondi social dhe Fondi pensionale, që në të ardhmen mos të mbesin prapë kategoritë e përziera. Skemat pensionale duhet të kenë prioritet moshën, sepse problemet në sistemin pensional në Kosovë, janë që një kohë të gjatë.

Rritja e fundit nuk ka pasur ndikim të madh te pensionistët sepse edhe rritjen e pagave e edhe të pensioneve nuk e kemi të bazuar në kritere dhe me koston e jetesës.

Çështja e trustit, është një instrument që na është imponuar dhe deri tani e mban monopolin dhe është e kufizuar mundësia se si do të shfrytëzohen. Çështja e pensioneve të grabitura nga Serbia, ne e dimë që njerëzit kanë kontribuar në atë fond dhe Serbia e ka obligim që t'i paguaj kontributdhënësit. Ne si shtet duhet ti bëjmë presion që kjo e drejtë e pamohueshme e fituar nga puna të realizohet.

Gjithashtu, një çështje tjetër po e ngre, janë vdekjet që po ndodhin në vendin e punës, prandaj kërkoj t'i trajtoni me seriozitet.

Drita Millaku: Është e domosdoshme që të bëhet një reformë e skemave pensionale, sepse edhe ju e përmendët që keni hasur në mosharmonizim të ligjeve të cilat edhe i diskriminojnë shumicën e qytetarëve, konkretisht pensionistët.

A keni bërë tek ky koncept dokument një plan të veçantë? Çfarë do të bëhet me fonde të pensioneve të cilat sot janë në Serbi dhe a keni bërë ndonjë plan se si do t'i ktheni këto fonde prapë në Kosovë?

Pyetja tjetër ka të bëjë me personat që lëndohen në vendin e punës. Ata duhet ti gëzojnë dy pensionet edhe pensionin kontributdhënës edhe atë të invaliditetit. A jeni duke ndërmarrë diçka në këtë drejtim?

A keni menduar të ndani një buxhet për kompensim apo një skemë të veçantë sociale për familjet e personave që po humbin jetën, qoftë në vendet e punës apo në aksidente të komunikacionit, si rastet e fundit që kanë ndodhur?

Time Kadrijaj: Vet fakti që janë 23 skema pensionale, do të thotë përfshihen një pjesë e madhe e popullsisë sonë. Mirë që e keni bërë një koncept dokument, por unë propozoj që të merret për bazë edhe Komisioni që është formuar nga Kuvendi dhe bashkërisht të punohet në mënyrë që të rregullohen njëherë e përgjithmonë skemat pensionale.

A do të kujdeseni që punën e përbashkët që do ta bëni me Komisionin që është votuar në Kuvendin e Kosovës, t'i rregulloni këto kundërshtime që janë në mes të ligjeve, të largohen dhe mos të kemi më probleme të natyrës së tillë.

Enver Hoti: Është shumë me rëndësi që ju keni punuar një koncept dokument për reformën pensionale, i cili sigurisht siç thatë edhe vet është ende në Qeveri. Po shihen që problemet janë të mëdha. Kemi mbi 20 skema pensionale dhe mendoj që është momenti i fundit që duhet t'iu japim zgjidhje këtyre problemeve. Unë mendoj që duke i vendosur ato shtylla, siç e thatë ju mund t'iu japim zgjidhje të gjitha problemeve. Për fondet e grabitura nga ana e Serbisë, nuk është punë vetëm e Ministrisë tuaj. Ne duhet të jemi të gjithë së bashku në një zë kundër Serbisë në aspektin politik dhe mos të bëjmë shumë lojëra sepse nuk është çështje që mund ta adresojë një ministri, për është çështje institucionale shtetërore.

Unë jam pjesë e Komisionit Parlamentar që është krijuar për reformën pensionale dhe sigurisht ministër do të garantojë që Komisioni dhe deputetët të gjithë do të kenë gatishmëri që në punën tuaj që keni punuar aq gjatë, ta marrim, ta trajtojmë dhe me punën e përbashkët ta bëjmë më të mirën për vendin.

Besa Baftiu, kryetare, tha se përse është një gjendje e tillë, nuk mund t'ia lëmë fajin ndoshta Qeverisë çdo herë, sepse edhe ne jemi pjesë e punës së draftimit të ligjeve dhe gjithçka që ka ardhur nga Qeveria, është Komisioni i fundit, ai i cili e dërgon në Kuvendin e Republikës së Kosovës që të votohet, prandaj unë po besoj që ne si Komision dhe Qeveria, duhet të jemi shumë të vëmendshëm që mos të përsëriten gabimet që janë përsëritur tash e njëzet vite, por me këtë që do të punohet, të bëhet zgjidhja më e mirë e mundshme.

Ministër Skender Reçica tha se natyrisht që jemi në një fazë kur nuk jemi ndal së punuari sa i përket reformës pensionale, por është një situatë kur iniciativa tash duhet të burojë nga komisioni dhe duhet ta them shumë qartë që MPMS do të jetë në dispozicion kurdo dhe kudo që komisioni kërkon për të bashkëpunuar. Sa i përket rritjes së pensioneve, realisht pas analizave që janë bërë nga Ministria e Financave sa i përket përbalimit financiar që mund ta quajmë ngritjes që i'u është bërë në skemat pensionale në këtë rast, në pensionet kontributdhënës dhe pensionet e moshës për shumë vite nuk ka pasur lëvizje. Mendoj që këtë vit buxheti mundet t'iu përballojë ngritjet në këtë shumë dhe në këto skema dhe natyrisht që kemi pasur diskutime, analiza, propozime që të përfshihen edhe skemat e tjera, sepse nuk ka munguar vullneti, por analizat buxhetore neve na flasin që duhet të kemi shumë kujdes që në një skemë që ne marrim vendim për rritje dua t'iu them një impakt që e kemi bërë këtë rritje, buxhetit të Kosovës i kushton tridhjetë milionë euro. Është një kosto që ne kur të marrim vendim duhet të kemi mjete që ta përballojmë. Natyrisht që mundësitë e para që do t'iu kemi mjetet buxhetore do kemi rritje edhe për skema tjera pensionale. Ka pasur propozime nga ana jonë si ministri për rritje për të gjitha skemat, por mundësitë buxhetore janë të tilla. Ky pragu 15 vjeçar i kontributit e ka burimin te

Ligji i vitit 2007 atëherë kur kanë filluar për herë të parë pensionet invalidore, të punës, dhe pensionet familjare. Thuhet se është marrë si kriter një ligj i KSAK-së i vitit 1986.

Po të analizohet sa do të jetë kosto buxhetore që ne e kemi paraparë në kuadër të reformës që të njihet e drejta dhe stazhi i atyre që janë larguar dhunshëm nga puna, është një kosto marramendëse që ne e kemi paraparë që ta fusim edhe në kornizën afat-mesme të shpenzimeve. Kemi menduar që koncepti do të miratohet këtë vit dhe do të punojmë që paralelisht deri në fund të vitit ta kemi ligjin dhe nga viti 2020 të planifikohen mjetet.

Sa i përket lajmrimin të pensionistëve të vdekur nga familjarët ende jemi larg nga kjo, prandaj kjo masë e paraqitjes së pensionistëve në qendrat çdo gjashtë muaj do të mbetet edhe për një kohë në mënyrë që mos të keqperdoren fondet e dedikuara për pensione.

Fondi pensional i grabitur nga Serbia, realisht mendoj që i kalon kompetencat e MPMS. Ka pasur iniciativë në të kaluarën nga burime të ndryshme, gjithashtu ka pasur iniciativa edhe nga vet pensionistët për padi në gjykatën e Strasburgut, nuk kam vërejtur që ka pasur një angazhim institucional shtetëror për këtë çështje. Edhe Avokati i Popullit përmendi një raport që në 2016 Qeveria e asaj kohe është dashur që të takohet me një kërkesë të gjykatës së Strasburgut, nuk ka pasur një reagim të tillë. Unë nuk kam ndonjë informatë zyrtare sa i përket procedurave që janë ndjekur nga insitucionet për t'u kthyer ky fond i grabitur.

Ne jemi duke vuajtur si pasojë që dikush në të kaluarën e ka quajtur pension atë që merr familja e dëshmorit, sipas mendimit tim ai nuk mund të quhet pension. Po të shikohet te shtylla e parë kemi disa skema të cilat mendohet të krijojnë një siguri edhe sociale edhe për mirqenien e të gjitha atyre familjeve, familjarët e të cilëve mund të pësojnë në vendin e punës, bëhet fjalë për pensionin invalidor të punës dhe pensionin familjar në të cilin punëtori do të punojë dhe do të ndajë kontributet, varësisht përqindjes që do të parashihet me ligj.

Çështjen e trustit, ne e kemi trashëguar, është një kursim, nuk është një fond pensional. Nëse analizat do të na tregonin që trusti është në rrugën e duhur ndoshta ne nuk do të mendonim për krijimin e një fondi për sigurime sociale.

Pensionet e dyfishta natyrisht që i kemi trajtuar në koncept dokument, u përmend kjo te pensionet kontributdhënëse, pastaj kemi pasur plot kategori që shpesh ligjet që bien ndesh njëra me tjetrën, natyrisht që në koncept dokument kemi dhënë rrugë se si të trajtohet kjo. Në rastet kur qytetarët mund të jenë kontributpagues, mund të jenë përfitues të skemave pensionale të cilat burojnë nga ligjet tjera, ligje të dala nga lufta dhe krejt këto i kemi menduar që të jenë me një kërkesë unike, sikur që e kemi menduar të jetë tavani më i lartë i pensioneve, dhe natyrisht një pensionist kontributpagues i cili mund të jetë prind i dëshmorit të ketë pensionin ndryshe nga një pensionist tjetër.

Bekim Haxhiu tha se po mendon që ligji i ardhshëm do të rregullojë shumë çështje, sepse derisa nuk ka pasur një dokument të përgjithshëm, atëherë është bërë një zgjidhje që duhet të shikohet në tërësi, krejt në fund dua të dijë se kur ka rritje për pensione të kategorive të dala nga lufta?

Skender Reçica tha se ne e kemi të miratuar buxhetin për këtë vit dhe natyrisht në rishikim të buxhetit që do të bëhet në pjesën e dytë të vitit nëse do të ketë hapësirë buxhetore dhe mundësi buxhetore do të ketë rritje. Dua ta përsëris edhe një herë vullnetin dhe gadishmërinë e gjithë qeverisë që të lëvizim me rritje edhe në skema të tjera.

Fatmire Kollçaku tha se çështja e pensioneve që mendojmë që Serbia e ka obligim ndaj nesh, unë mendoj që ministria juaj i keni njohësit më të mëdhenj nga kjo fushë dhe nga Qeveria nuk pres që dikush tjetër ta ngrisë këtë si problem, ju e shikuat që e kemi një rekomandim nga Avokati i Popullit për këtë fushë, e kemi këtë presion nga shoqëria tash e njëzet vite, dhe mendoj që ju, si

minisitri, duhet ta ngrisi këtë çështje, sepse e keni gjithë bazën juridike, morale, njëjtë edhe Kuvendi. Nuk bën që Serbia të mbetet në këtë drejtim e pandëshkuar.

Drita Millaku tha se sa i përket fondit social, thatë që e keni paraparë në koncept dokument, mirëpo tani për tani për këto rastet që janë duke ndodhur si rasti i fundit i humbjes së jetës së 22 vjeçarit, a keni planifikuar të ndani një buxhet, sepse Kryeministri në rastin e mëhershëm të humbjes së jetës së zëvendësministrit Daci, ndau buxhet për të. A keni paraparë edhe ju të ndani buxhet për këto raste?

Skender Reçica tha se si ministri, në rastet kur familjet mund të kenë fatkeqësi, qoftë të humbjes së antarëve në vendin e punës, qoftë edhe fatkeqësi që mund të vijnë nga natyra, ne e kemi një mundësi fare të vogël të kompenzimit në kuadër të rregullativës që na lejon, një kompenzim dhe ndihmë të menjëhershme, që është një shumë fare e vogël. Sa i përket kompenzimeve të familjeve, siç është rasti me të riun nga Theranda unë shpreh keqardhjen time, është e vërtetë që në të kaluarën Qeveria ka ndarë mjete për këto raste me fatalitet dhe besoj që vullneti, po të jenë mundësitë nuk do të mungojë, por nuk është në kompetencën time që të iniciojë këto kompenzime.

Time Kadrijaj tha se është shumë e pamoralshme dhe e pandrershme të fitosh në fatkeqësinë e tjetrit, të bëhet temë rastesh mirësia dhe edukata e z. Haradinaj, sepse z. Daci ka qenë pjesë e këtij institucioni dhe siç e dini z. Haradinaj e ka vizituar dhe liderin e juaj në spital dhe i ka ofruar përkrahje institucionale dhe është shumë e pamoralshme që këtu me përfitu me fatkeqësinë e dikujt tjetër.

Zbatimi i legjislacionit nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale

Kryetarja tha se po kalojmë në pikën e dytë, ju përgëzojmë për punën që ju e keni bërë në hartimin e legjislacionit. Është bërë praktikë që në Kuvend të miratohen ligje të cilat janë të mira, por nuk po zbatohen në praktikë, edhe nga fusha juaj ka ligje që janë miratuar në Kuvend, por nuk po zbatohen, disa prej tyre kanë filluar me vonesë. Sa jeni ju i kënaqur me zbatimin e ligjeve?

Dua të dijë që plotësim-ndryshimi i Ligjit për veteranët e luftës, e dimë se me një procedurë shumë të përshpejtuar në dhjetor 2016 është bërë plotësim ndryshimi, ku është bërë kategorizimi i veteranëve të UÇK-së që për mendimin tim ka qenë një e padrejtë që i'u është bërë. A është punuar në këtë drejtim për t'u bërë ky kategorizim?

U diskutua edhe për Ligjin për siguri dhe shëndet në punë, ne jemi dëshmitarë që askush nga ne as nga qytetarët nuk i gëzohet këtyre fatkeqësive dhe sa i përket këtij ligji e dimë që është edhe Inspektorati i Punës që është përgjegjësi kryesorë në zbatimin e ligjit dhe ne nuk jemi të kënaqur me zbatimin e këtij ligji.

Ministër Reçica tha se i përket kategorizimit të veteranëve, ministria në bazë të ligjit është e obliguar ta hartojnë rregullore për kategorizim, të cilën ministria e ka hartuar dhe është në pritje për miratim në Qeveri. Natyrisht që në kohën e fundit, sa i përket trajtimit të veteranëve ka pasur tema të cilat janë diskutuar gjërë e gjatë dhe unë besoj që nuk ka ndonjë arsye që rregullorja të mos miratohet në Qeveri, por vetë trajtimi i çështjeve të veteranëve me amendamentimin e këtij ligji ka bërë që për një kohë mos të miratohet kjo rregullore, jemi në bisedime edhe me Kryeministrin dhe me Qeverinë që kjo rregullore të zbatohet.

Situata për Siguri dhe Shëndet në Punë është larg nga aty ku ne dëshirojmë ta kemi. Do akoma më shumë punë, nuk po them që Inspektorati i Punës nuk është duke u angazhuar, por do angazhim të përgjithshëm si të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Ne tashmë e kemi sjellë në Parlament ligjin e

punës, ligj ky i cili avancon të drejtat e punëtorëve dhe monitorimin e tij nga ana e Inspektoratit të Punës. Me ligjin aktual shpesh hasim në paqartësi edhe në zbatim e tij. Gjatë vitit të kaluar, ne, si ministri, së bashku me Inspektoratin e Punës kemi dalë në terren, numri dhe statistikave tregojnë një numër të madh të inspektimeve krahasur me vitet e kaluara, por edhe këto inspektime nuk e kanë dhënë rezultatin çfarë ne e kemi dëshiruar.

Është e pamundur që ne me kapacitetet aktuale, por edhe me shtimin e kapaciteteve që ne kemi parapar këtë vit, të arrijmë që në çdo punishte të ketë inspektor dhe që ai inspektor të bëhet gardian i sigurisë të punëtorit në punë. Në qoftë se nuk arrijmë që të vetëdijesohemi që të ketë siguri në punë është e pamundur që të ketë sukses. Kemi pas 120 punishteve vetëm në Prishtinë, ku i'u kemi pezulluar punën dhe është dashur vetëm një javë që këto punishte t'i plotësojnë krieteret bazë për siguri në punë. Githashtu kemi inspektuar edhe vendet e tjera të Kosovës dhe ka rezultate të mira. Do vazhdojmë edhe këtë vit me inspektime.

Kryetarja tha se po shohim se keni marrmasa por janë të pa mjaftueshme, a keni parapa mundësin që landa siguria dhe shëndeti në punë të përfshihet edhe në kurikulat e arsimit?

Ministër Reçica tha se këtë vit e kemi parapa hartimin e strategjis nacionale per sigurin dhe shëndetin në punë dhe natyrisht se do të involvohen edhe dikasteret tjera edhe Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë.

Fatmire Kollaçku- Meqenëse e kemi edhe kryetaren e Komisionit për verifikim të viktimave të dhunuara gjatë luftës, e di që është folur shumë në debate të ndryshme, dua të na informojë shkurt rreth ankesave që ka pasur nga viktimat e luftës të cilat ndoshta nuk po arrijnë ta dëshmojnë. Mirëpo unë mendoj që një viktimitë e kësaj dhune shumë vështirë do të dalë dhe të thotë jam viktimitë në qoftë se nuk e ka përjetuar.

Çështja tjetër është çështja e strehimoreve të viktimave të dhunës në familje. Ministër, bordi i grave deputete në Kuvend ka propozuar dhe është përkrah një amandament, ku këto mjete të jenë vetëm për strehimore, mirëpo nga takimi që e kemi pasur me përfaqësues nga ministria juaj një shumë prej 500 mijë euro ka qenë e dedikuar dhe është paraparë që t' ju shtohet edhe 300 mijë dhe kjo t' ju distirubutohej OJQ-ve dhe tash këto strehimore nuk do të fitojnë as për së afërmi këtë shumë, dhe unë nga ju kërkoj sqarim për këtë çështje.

Shteti duhet të merr obligim t'i përkrahë këto strehimore.

Drita Millaku pyeti sa është efikas enti për punësim?

Bekim Haxhiu tha se moszbatimi i ligjeve ka qenë fatal për disa të punësuar. Kërkoj që siguria dhe shëndeti në punë të jetë në një nivel më të lartë dhe është detyrë edhe e jona t'i monitorojmë këto ligje. Kemi ankesa të vazhdueshme të zbatimi i ligjit, sa i përket beneficioneve të familjeve të dëshmorëve. Moszbatimi i këtij ligji po ju sjell pasoja, prandaj i ftoj fëmijët e dëshmorëve që kurdo që ju shkelen të drejtat që ju janë dhënë me ligj sidomos te përparsia në punësim të ankohen te inspektorati i punës.

Ministër Skender Reçica tha se kemi filluar me procedurat sa i përket buxhetit të ndarë për strehimore, në rrugë e sipër është shtuar buxheti, ne jemi duke e shikuar bazën ligjore se a kemi të drejtë atë buxhet të shtuar ta shfrytëzojmë në një rrugë që e kemi nisur me një buxhet tjetër dhe nëse ka bazë ligjore natyrisht që nuk do të ndjekim për të dytën herë procedurat e njëjta.

Sa i përket zyreve të punësimin, ne kemi zyre të punësimin në secilën Komunë të Kosovës, kemi tetë qendra të aftësimin profesional dhe dua ta shpreh admirimin tim për punën që e bëjnë këto zyre të punësimin. Në vitin e kaluar kemi pasur punë kërkuar mbi 95.000 qytetarë dhe të gjitha

këto zyre të punësimit kanë përjetuar kërkesat e këtyre punëkërkesve. Ne nuk jemi ministri që të hapim vende të punës dhe në momentin që një qytetar të paraqitet ne menjëherë ta punësojmë. Vitin e kaluar mbi mbi 12.000 punëkërkes i kemi trajtuar, mbi 3500 maska aktive të tregut të punës dhe këto janë ato mundësi që ne mund t'i ofrojmë për qytetarët. Sa i përket punësimit të familjeve të dëshmorve duhet një koordinim më i madh ndërinstytucional.

Minire Balaj tha se ne, si komision kompetent profesional, jemi duke e bërë më të mirën. Jemi duke punuar vazhdimisht në këtë proces, i kemi mbi 940 aplikime në nivel vendi. Çka po e bën këtë proces më praktik është mënyra e aplikimit që është paraparë me ligj, është konfidencial dhe çështja e rishqyrtimit të kërkesave në komision. Ne po mundohemi që çdo hap që ligji na lejon për këtë kategori ta shfrytzojmë. Është fakt që jemi me vonesë në disa gjëra, i kemi shqyrtuar vetëm 400 lëndë, i kemi 219 pranime, afër 100 kërkesa i kemi në shqyrtim në proces, 27 lëndë i kemi refuzuar përfundimisht. Ne jemi të sigurt që secilit rast jemi duke i'u dhënë kohën e duhur që komisioni të jetë në gjykim të drejtë. Ne punojmë tri herë në javë, i shqyrtojmë 30-40 aplikacione dhe jemi duke e bërë më të mirën të mundshme për këtë proces.

Kryetarja: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU